

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani anëtarë, në çështjen juridike të paditësve V. K., S. K., E. K. dhe S1. K., nga Komuna e Podujevës, të cilët i përfaqëson av.Z.B., nga Prishtina kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F. C., me autorizim, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4035/2013 datë 11.07.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 1.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pathemeltë revizioni i paditësve paraqitur kundër pjesës I-rë dhe II-të të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4035/2013 dt.11.07.2016.

Pjesa e III-të e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së dytë nuk u shqyrtua.

A r s y e t i m i

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2103/07 dt.23.04.2013, është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësve, detyrohet e paditura që për shkak të dëmit të pësuar nga aksidenti i trafikut i datës 22.07.2005, t'i paguajë paditësit V. K., për dëmin jo material, për dhimbje fizike shumë prej 1500€, për frikë 2700€, paditëses S. K., për dhimbje fizike, shumë prej 1750€, për frikë 3000€, paditëses E. K., për dhimbje fizike shumë prej 1450€, për frikë 2800€, paditësit S. K., për dhimbje fizike shumë prej 1900€ dhe për frikë shumë prej 2900€, me kamatë ligjore në lartësi prej 12% nga dita e marrjes së aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.016€.

Pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve përtej shumave të gjykuara, e ka refuzuar si të pabazuar.

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4035/13 dt.11.07.2016, ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që detyrohet e paditura që paditësit të parë, për dëmin jo material, për dhimbje fizike t'i paguajë shumë prej 800-€, për frikë 900€, paditëses së dytë, për dhimbje fizike shumë prej 900€, për frikë 1000€, paditëses së

tretë, për dhimbje fizike shumë prej 700€, për frikë 800€, paditësit të katërt ,për dhimbje fizike 1000€ dhe për frikë 800€, po ashtu, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë edhe për kamatën, ashtu që në vend të kamatës së gjykuar sipas shkallës 12% i gjykohet kamata që paguajnë bankat afariste në mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit dhe në pjesën tjetër ka refuzuar ankesën e të paditurit si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë(pjesës refuzuese)në afat ligjor,kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që të miratohet revizioni, të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së dytë, ndërsa, të lehet në fuqi ai i shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni i paditësve është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës(raporti Policisë, Ekspertizat mjekësore, ekspertiza e komunikacionit, etj) rrjedh se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datë 22.07.2005 në rrugën magjistrale Prishtinë-Podujevë, në të cilin kanë marrë pjesë automjetet VW Kombi me tabela të regj...,të cilin e drejtonte M. R., nga Podujeva dhe automjeti i markës Audi me targa ..., të cilin e drejtonte Xh. K., se aksidenti i dt.22.07.2005, është shkaktuar me lëshimet e të siguruarit të paditurit i cili po drejtonte automjetin Kombi me targa 476-KS-411,M. R.,ku paditësit kishin qenë bashkudhëtar. Se nga ky aksident paditësi Vehbi, ka pasur lëndime si shtypje në kraharorin e djathtë, gërvishje në bërrylin e majtë, plagë shqyese dhe dërmuese në kokë në anën e majtë,të cilat u vlerësuan si lëndime të lehta trupore. Paditësja S., ka marrë lëndime si shtypje në regjionin e qafës, shtypje të gjurit të majtë dhe plagë shqyese në gjurin e majtë, të cilat poashtu janë kualifikuar si lëndime të lehta trupore. Paditësja E., ka marrë lëndime si gërvishje në shpinë dhe kraharor nga ana majtë si dhe në pjesën gjytale, të cilat lëndime janë vlerësuar si lëndime të lehta trupore, paditësi S. ka pasur plagë shqyese në kokë, shtypje të kokës dhe po ashtu janë vlerësuar si lëndime të lehta trupore. Paditësi V., ka pasur dhimbje të intensitetit të lartë një orë, të mesëm 7 ditë, të ulët kohë pas kohe ndjen edhe më tej. Paditësja S., dhimbje fizike të intensitetit të lartë një orë, të mesëm 10 ditë, të ulët 3 javë. Paditësja E., dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 7 ditë, të ulët 2 javë. Paditësi S., (i mitur)dhimbje fizike të intensitetit të lartë një orë, të mesëm 7 ditë, të ulët 2 javë. Paditësi V., ka pasur frikë primare disa sekonda, që

manifestohet në të menduarit e tij për zhvillimin tragjik të ngjarjes për të dhe familjen e tij (me gruan dhe fëmijët), frikë sekondare e shkallës së lartë 3 orë, që është manifestuar me preokupimet e gjendjes së familjes së tij pas aksidentit dhe nënshtrimit të procedurave mjekësore, frikë të intensitetit mesatar një muaj, të ulët tre muaj. Paditësja S., ka pasur frikë primare disa sekonda, frikë sekondare e shkallës së lartë 3 orë, që është manifestuar për preokupimet e sajë për burrin dhe fëmijët e sajë, frikë e intensitetit mesatar 2 muaj, të ulët tre muaj. Paditësja E., frikë sekondare të intensitetit të lartë 2 orë, frikë të intensitetit mesatar dhe të ulët 3 javë dhe paditësi S., nuk ka pasur frikë primare, frikë sekondare e intensitetit të lartë 2 orë, që është manifestuar me ankth, shqetësime psikike, fantazi fëmijërore, frikë të intensitetit mesatar tri javë, të ulët tre muaj.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, e ka miratuar pjesërisht ankesën e së paditurës, ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitivin e sipër theksuar të aktgjykimit të sajë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur ka miratuar pjesërisht ankesën e së paditurës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në kuptimin e më sipërm, ndaj, aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje të karakterit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Për sa i përket kamatës dhe shumave të gjykuara nga Gjykata e shkallës së dytë (pjesa e ndryshuar) përkitazi me llojet e sipër përmendura të dëmit jo material, drejtë është aplikuar e drejta materiale përkatësisht dispozita e nenit 200 të LMD-ës e lidhur me nenin 323 të LPK-ës, duke pasur parasysh konstatimet dhe mendimet e ekspertëve përkatës mjekësor, lëndimet e pësura trupore dhe pasojat, natyrën, peshën, intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës së paditësve. Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jo material (si një satisfakcion që nuk ka qëllim lukrativ-fitimprurës), përfaqëson zbatimin e së drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, edhe të frikës si lloj i mëvetësishëm i dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por, edhe për çështjen që të mos

favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror, prandaj, duke pasur parasysh këto kritere të parapara me dispozitën e lartë cekur, shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë, përkitazi me llojet e sipër cekura të dëmit jo material, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale, në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore.

Prandaj, nga këtu, thëniet e revizionit të paditësve për shkeljen e së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së dytë përkitazi me lartësinë e shumave të gjykuara, kjo Gjykatë i vlerësojë si të pathemelta, pra, edhe për faktin sepse sikundër u theksua më lartë, lartësia e shumave të gjykuara për llojet e dëmit jo material të paditësve nga gjykata e shkallës së parë, ishte në disproporcion (në disharmoni), veg tjerash, edhe me natyrën dhe peshën e lëndimeve të pësuara të paditësve (lëndime të lehta trupore). Po ashtu, lidhur me kamatën për të cilën ka vendosur gjykata e shkallës së parë (12%), nuk ka mundur të aplikohen dispozitat e nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia (2011), nga se rasti i aksidentit, lidhur me të cilin kërkohet kompensimi i dëmit, ka ndodhur me datë 22.07.2005, ndërkohë që, Ligji përkatës nuk ka efekt retroaktiv, vlen vetëm për të ardhshmen, jo edhe përkitazi me dëmet e shkaktuara para hyrjes së tije në fuqi.

Pjesa e III-të e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk u shqyrtua sepse nuk ishte goditur me revizion.

Nga sa u theksua më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.360/2016 datë 1. 02. 2017

Kryetari kolegjit
Mr.sc.Muhamet Rexha